



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 703 Prot.

Tiranë, më 18.04. 2025

VENDIM

Nr. 19, Datë 17.04.2025

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES PËR AKORDIMIN E TITUJVE AKADEMIKË
“PROFESOR EMERITUS” DHE “DOCTOR HONORIS CAUSA”**

Mbështetur në nenin 38 , pika 1, germa “d” të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 24, pika 1, germat “g” dhe “h” të Statutit të Universitetit të Arteve, në kreun V, pikat 1 dhe 2 të VKM nr. 112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” si dhe standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i asocuar” dhe “Profesor”, i ndryshuar, Senati Akademik i Universitetit të Arteve, pas shqyrtimit dhe diskutimit të draft-rregullores, me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores për akordimin e titujve akademikë “Profesor Emeritus” dhe “Doctor Honoris Causa”, sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ky vendim si dhe teksti i plotë i Rregullores të publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe t'i dërgohet për njohje dhe zbatim 3 (tre) njësive kryesore të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Arben LLOZI

Prof. Najada HAMZA

Prof. Miltiad KUTALI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Rudina CIKO

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Genci FUGA

Prof. Asoc. Orion Shima

Rei KITA (Student FM)

Prof. Lorenc RADOVANI

Prof. Endri SINA

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Kristina LAÇO

Prof. Asoc. Alert ÇELOALIAJ

Enea TRIMI (Student FAB)





**RREGULLORE
PER AKORDIMIN E TITUJVE "PROFESOR EMERITUS" DHE
"DOCTOR HONORIS CAUSA"
NË UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Miratuar me VSA nr. _____, datë _____._____.2025

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti**

Kjo rregullore ka per qëllim të përcaktojë kriteret dhe procedurat për akordimin e titullit akademik "Profesor Emeritus" dhe titullit "Doctor Honoris Causa" në Universitetin e Arteve.

**Neni 2
Baza ligjore**

Baza ligjore për hartimin e kësaj rregulloreje është neni 61, pika 5 e ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqiperisë", në nenin 24, pika 1, germat "ff" dhe "gg", si dhe kreu V, pikat 1 dhe 2 të vendimit nr. 112, datë 23.02.2018 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe te standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademike "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", i ndryshuar.

**Neni 3
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë kriteret e fitimit të titullit "Profesor Emeritus" dhe "Doctor Honoris Causa" në Universitetin e Arteve, strukturat përgjegjëse dhe rregullat standarde për kryerjen e kësaj procedure.

KREU II
TITUJ PËR KONTRIBUT TË VEÇANTË
“PROFESOR EMERITUS”

Neni 4
Kriteret për akordimin e titullit "Profesor Emeritus"

1. Personeli akademik që mban titullin "*Profesor*", i cili ka ushtruar veprimitarinë akademike për të paktën 30 vite në Universitetin e Arteve, pas daljes në pension pleqërie, në vlerësim të veprimitarisë së spikatur akademike, me propozim të njësisë bazë ku ka zhvilluar karrierën e tij dhe me vendim të Senatit Akademik të Universitetit të Arteve, i akordohet titulli "*Profesor emeritus*", pasi merret pëlqimi i ministrisë pergjegjëse për arsimin e lartë.
2. Titulli "*Profesor emeritus*" u jepet profesorëve në pension pleqërie, të cilët kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në drejtim të veprimitarisë akademike, duke përfshirë dhe arritjet e dedikuara në fushën përkatëse të kërkimit shkencor/artistik.
3. Titulli i nderit "*Profesor emeritus*" i jepet personelit akademik, që plotëson kriterin e përgjithshëm të mbajtjes së titullit "*Profesor*" së paku prej 5 vitesh.
4. Individ që mban titullin "*Profesor emeritus*" nuk mund të jetë punonjës efektiv i Universitetit të Arteve. Nëse individ që mban titullin "*Profesor emeritus*", për arsyen apo nevoja të ndryshme të Universitetit të Arteve kthehet në punë, atëherë ai trajtohet financiarisht si personel akademik "*Profesor*".
5. Titulli akademik "*Profesor Emeritus*" nuk jepet pas ndarjes nga jeta të anëtarit të personelit akademik.
6. Numri i titujve "*Profesor Emeritus*" të akorduara nuk mund të jetë më shumë se 2 (dy) në vit për çdo njësi kryesore.

Neni 5
Procedura e aprovimit të titullit "Profesor emeritus"

1. Njësia bazë, me iniciativë të saj apo të një personi juridik, me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të saj, bën propozimin me shkrim për dhënien e titullit akademik "*Profesor Emeritus*". Ky propozim i përcillet drejtuesit të njësisë kryesore, së bashku me një kopje të *Curriculum vitae* si dhe veprimitari të tjera, si më poshtë:
 - a) pëlqimin e profesorit në formë deklarate;
 - b) relacion mbi performancën e mësimdhënies dhe punën e tij krijuese nga njësia bazë, ku ai ka ushtruar veprimitarinë si personel akademik;
 - c) relacione mbi rezultatet e punës mësimore, kërkimore dhe artistike si dhe (nëse ka) dëshmi kualifikimesh brenda dhe jashtë shtetit, çmime kombëtare/ndërkombëtare, bursa kualifikimesh e bashkëpunimesh me institucionet e huaja, realizime projekte/aktivitetesh artistike të përbashkëta/individuale, çertifikata referimesh dhe pjesëmarrje në konferanca dhe veprimitari të tjera, certifikata nderi, artikuj në median e shkruar, materiale audiovizive etj;
 - d) të paktën 2 (dy) rekomandime, prej të cilave minimalisht 1 (një) duhet duhet të jepet nga një anëtar i njësisë bazë me titullin profesor, nga njësia bazë dhe/ose institucionet

homologe, dikastere, qendra studimore dhe eksperimentale, nga institucione të fushës së artit, borde pedagogjike dhe studentore.

2. Dekanati shqyrton propozimin e njësisë bazë, bashkë me dokumentat e lartpërmendur dhe i përcjell me shkresë tek Rektori i UART, duke dhënë edhe opinionin e tij.
3. Rektori pasi gjykon veprimtarinë e profesorit dhe përputhshmërinë ligjore të dosjes, i drejtohet ministrisë përgjegjëse për arsimin.
4. Pasi Rektori merr pëlqimin nga ministria përgjegjëse për arsimin, i përcjell Senatit Akademik propozimin për miratimin e titullit.
5. Senati Akademik, me shumicë votash, vendos miratimin ose mosmiratimin për dhënien e titullit akademik "*Profesor emeritus*".
6. Vendimi i Senatit Akademik i përcillet strukturës përkatëse për regjistrim në regjistrin shtetëror të gradave dhe titujve pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë si dhe në regjistrin e UART.
7. Pas regjistrimit, UART përgatit certifikatën, të cilën e firmos Kryetari i Senatit dhe në një ceremoni, drejtuesi i njësise kryesore dhe/ose Rektori i dorëzojnë Profesorit titullin "*Profesor emeritus*".
8. Forma dhe përbajtja e kartonit të titullit miratohet nga Senati Akademik i Universitetit të Arteve.

**KREU III
TITUJ PËR KONTRIBUT TË VEÇANTË
“DOCTOR HONORIS CAUSA”**

**Neni 6
Kriteret për akordimin e titullit "*Doctor Honoris Causa*"**

1. Universiteti i Arteve mund të akordojë titullin "*Doctor Honoris Causa*" për figura të shquara të shkencës e shoqërisë, brenda dhe jashtë vendit, për kontribut të veçantë në zhvillimin e arsimit e të shkencës/arteve, si dhe në zhvillimin e vendit tonë në tërsësi.
2. Ky titull jepet me vendim të Senatit Akademik të UART, pasi merret pëlqimi i ministrisë përgjegjëse për arsimin.
3. Titulli akademik "*Doctor Honoris Causa*" nuk jepet pas ndarjes ngajeta të individit.
4. Numri i titujve "*Doctor Honoris Causa*" të akorduara nuk mund të jetë më shumë se 2 (dy) në vit.

**Neni 7
Kriteret për akordimin e titullit "*Doctor Honoris Causa*"**

Përgjegjësi i Njësisë Bazë, me iniciativë të tij apo të një personi juridik, bën propozimin me shkrim për dhënien e titullit "*Doctor Honoris Causa*", i cili i përcillet drejtuesit të njësisë kryesore, së bashku me një kopje të *Curriculum vitae* si dhe veprimtari të tjera, si më poshtë:

- e) pëlqimin e personit në formë deklarate;
- f) relacion mbi kontributet e veçanta në fushën përkatëse (p.sh. shkencë, kulturë, art, teknologji, etj.) nga njësia bazë që bën propozimin;
- g) relacione mbi rezultatet e punës në fushën përkatëse si dhe (nëse ka) dëshmi kualifikimesh brenda dhe jashtë shtetit, çmime kombëtare/ndërkombëtare, bursa kualifikimesh e

- bashkëpunimesh me institucionë të huaja, realizime projektesh/aktivitetesh artistike të përbashkëta/individuale, çertifikata referimesh dhe pjesëmarrje në konferenca dhe veprimtari të tjera, çertifikata nderi, artikuj në median e shkruar, materiale audiovizive etj
- h) të paktën 2 (dy) rekomandime nga njësia bazë dhe/ose institucionë homologe, dikastere, qendra apo institucionë të fushave përkatëse.
 - 9. Dekanati shqyrton propozimin e njësisë bazë, bashkë me dokumentat e lartpërmendur dhe i përcjell me shkresë tek Rektori i UART, duke dhënë edhe opinionin e tij.
 - 10. Rektori pasi gjykon veprimtarinë e personit të propozuar dhe përputhshmërinë ligjore të dosjes, i drejtohet ministrisë përgjegjëse për arsimin.
 - 11. Pasi Rektori merr pëlqimin nga ministria përgjegjëse për arsimin, i përcjell Senatit Akademik propozimin për miratimin e titullit.
 - 12. Senati Akademik, me shumicë votash, do të vendosë nëse do të miratojë propozimin dhe nëse do të marrë vendimin për dhënien e titullit akademik "*Doctor Honoris Causa*".
 - 13. Vendimi i Senatit Akademik i përcillet strukturës përkatëse për regjistrim në regjistrin shtetëror të gradave dhe titujve pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë si dhe në regjistrin e UART.
 - 14. Pas regjistrimit, UART përgatit kartonin, të cilin e firmos Kryetari i Senatit, dhe në një ceremoni, drejtuesi i njësisë kryesore dhe/ose Rektori i dorëzojnë personit titullin "*Doctor Honoris Causa*".
 - 15. Forma dhe përbajtja e kartonit të titullit miratohet nga Senati Akademik i Universitetit të Arteve.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 8

Miratimi, zbatimi dhe ndryshimi i rregullores

- 1. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit të saj nga Senati Akademik i UART.
- 2. Kjo rregullore është e detyrueshme për t'u zbatuar si e tillë nga të gjitha njësitë kryesore të UART.
- 3. Propozimet për ndryshime mund të vijnë nga Rektorati i UART, njësitë kryesore apo njësitë bazë.